



REPUBLIKA E KOSOVË - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dip: \_\_\_\_\_  
 Dep: DPKI  
 Nr.faq: \_\_\_\_\_  
 Broj. strana: 05  
 Nr. pages: \_\_\_\_\_

Nr. Prot: \_\_\_\_\_  
 Bi Prot: \_\_\_\_\_  
 Prot No: 06-02/92/22  
 Data: \_\_\_\_\_  
 Datum: 14-01-2022

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVË - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot: 082  
 Bi Prot: \_\_\_\_\_  
 Prot No: \_\_\_\_\_  
 Data: \_\_\_\_\_  
 Datum: 19/01/22

DATË/A:	13.01.2022
REFERENC-Ë:	AKK-DPKI-06-1850/21
PËR/ZATO:	znj. Kumrije Gagica, Udhëheqëse e Divizionit për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
CC:	znj. Hasnije Ilazi, Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll Buleshkaj, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	z. Esad Ejupi, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesën për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit

E nderuara znj. Gagica,

Lidhur me kërkesën tuaj për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, në mbështetje të nenit 21 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

**NJOFTOHENI se:**

Agjencia kundër Korrupsionit, në kuadër të kompetencave të saj lidhur me konfliktin e interesit, ofron këshillim për zyrtarët e lartë të veçantë, udhëheqësve, institucioneve udhëheqëse, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, përfshirë këshillime të veçanta për personat zyrtarë sipas këtij ligji pasi janë shteruar mjetet e brendshme në institucionet punëdhënëse dhe kur gjykohet e domosdoshme përfshirja e Agjencisë.

Me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përcaktohet obligimi për parandalimin e konfliktit të interesit nga vet institucionet publike, përmes Autoriteteve përgjegjëse brenda institucionit përkatës. Kjo do të thotë se, rekomandohet që fillimisht situatat e tilla të vlerësohen brenda vet institucionit tuaj. Ndërsa Agjencia është autoritet qendror për zbatimin e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesën tuaj të parashtruar në formë të shkruar (DPKI-06-1850/21), me të cilën keni kërkuar që të njoftoheni se a përbën konflikt të interesit nëse i njëjti person që është anëtar i Këshillit Shtetëror për Njohje të Diplomave në NARIC/MASHT, i zgjedhur me vendim të Ministrit, është edhe anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës.

Me qëllim të trajtimit të rastit në mënyrë të gjithanshme si dhe nxjerrjes së një përgjigje adekuate për pyetjen e adresuar nga ana e juaj, Agjencia kundër Korrupsionit në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 21 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka kërkuar informata shtesë, respektivisht, precizimin e kërkesës suaj sa i përket subjektit të ndërlidhur me rastin. Lidhur me këtë, përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-2013/21), keni potencuar se fjala është për anëtarin e Këshillit Shtetëror për Njohje, z. Gëzim Tosuni.

Agjencia kundër Korrupsionit konform mandatit që ka, pas shqyrtimit të kërkesës suaj dhe pas analizimit të dokumentacionit në dispozicion, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ju njofton si në vijim:

Fillimisht, me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar definicioni i konfliktit të interesit sipas të cilit: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”* (neni 6, paragrafi 1).

Me Udhëzimin Administrativ (MASHT)-Nr. 16/2016 Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës<sup>1</sup> [Neni 5, Këshilli Shtetëror për Njohje], është përcaktuar që anëtarët e Këshillit Shtetëror për Njohje (tutje: KSHNJ) emërohen nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ndërsa me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, respektivisht, në paragrafin 4, neni 7 [Agjencia e Kosovës për Akreditim] të këtij ligji është përcaktuar se:

*“4. AKA duhet të qeveriset nga një bord i përbërë nga jo më pak se pesë dhe jo më shumë se nëntë persona, të emëruar nga Ministria për një mandat të caktuar [...]. Ky bord do të quhet Këshilli shtetëror i cilësisë i AKA-së. Anëtarët e tij ratifikohen nga Kuvendi. Vendimet apo rekomandimet lidhur me akreditimet Këshilli i merr me shumicën e votave të anëtarëve të vet. Këshilli i raporton çdo vit Ministrisë dhe Kuvendit lidhur me aktivitetet e veta të akreditimit dhe me përshtatshmërinë e infrastrukturës mbështetëse që ka në dispozicion”.*

Nga dispozita e lartcekur rezulton se anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (tutje: KSHC) të Agjencisë së Kosovës për Akreditimi (tutje: AKA), emërohen nga Ministria<sup>2</sup> (në vartësin e të cilës është AKA), ndërsa të njëjtit ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Të njëjtit anëtar i raportojnë Ministrisë dhe Kuvendit.

Si rrjedhojë, z. Tosuni si zyrtar i emëruar në organin shtetëror (anëtar i KSHNJ-së) në kuadër të MASHTI-it, nuk mund të jetë njëkohësisht edhe anëtar i KSHC-së të AKA-së, pasi që kjo situatë

<sup>1</sup> UA në fjalë është nxjerrë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë më datë 12.08.2016 dhe atë në bazë të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

<sup>2</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

bie ndesh me dispozitën e nenit 11 [Punët e ndaluara për zyrtarin] paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e cila përcakton se:

*“1. Zyrtarit i ndalohet që të kryej punë të tera nëse:*

*[...] 1.4. angazhimi ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin në institucione vartëse të institucionit punëdhënës, me përjashtim kur një angazhim i tillë është paraparë me ligj të veçantë.”*

Nga kjo dispozitë rezulton se, zyrtarit, respektivisht, anëtarit të KSHNJ-së i ndalohet që të kryej punë tjera, në këtë rast si anëtar i KSHC-së në AKA, pasi që një angazhim i tillë ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin e tij në institucione vartëse (në KSHC të AKA) të institucionit punëdhënës (KSHNJ të MASHTI-it). Kurse, emërimi i anëtarit të KSHNJ-së në KSHC nuk është emërim që thirret sipas ligjit ex officio.

Çështjen e vartësisë (jo të varësisë apo pavarësisë) së AKA/KSHC-së ndaj MASHTI-it, Agjencia e ka trajtuar vetëm për qëllim të interpretimit dhe në kuptim të dispozitës së nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Në këtë kuptim, AKA/KSHC është institucion vartës i MASHTI-it, si institucion punëdhënës i anëtarit të KSHNJ-së.

Kjo përcaktohet me dispozitat e Ligji nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si në vijim:

Sipas neni 9 [Organizimi i administratës shtetërore] të këtij ligji, është përcaktuar se:

*“1. Administrata shtetërore përbëhet nga Zyra e Kryeministrit, sistemet ministrore dhe agjencitë rregullatore.*

*2. Sistemi ministror përbëhet nga:*

*2.1. ministria;*

*2.2. agjencia ekzekutive, dhe*

*2.3. administrata e shërbimeve publike.”*

Ndërsa me nenin 10 [Përgjegjësia për administratën shtetërore] të ligjit në fjalë, është përcaktuar:

*“1. Ministri është përgjegjës para Qeverisë dhe Kuvendit për veprimtarinë e të gjithë sistemit ministror në fushën e përgjegjësisë shtetërore të përcaktuar me legjislacionin përkatës.*

*2. Ministri (në vijim: ministri përgjegjës) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e sistemit ministror dhe mbikëqyr veprimtarinë e agjencive në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, në pajtim me këtë ligj.”*

Tutje, me nenin 11 [Ministria] përcaktohet se:

*“1. Ministria është përgjegjëse për hartimin e politikave publike, për drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë.*

Në rastin konkret, sipas dispozitës së sipërsënuar, MASHTI-i është përgjegjëse për hartimin e politikave publike, për drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit

ministrior, në këtë rast edhe për AKA/KSHC-në si agjenci ekzekutive në kuadër të sistemit ministrior të MASHTI-it.

Dispozita e nenit 12 [Agjencia Ekzekutive] të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, është kruciale për përcaktimin e vartësisë (jo të varësisë) së AKA/KSHC ndaj MASHTI-it. Më këtë dispozitë është përcaktuar se:

*“1. Agjencia Ekzekutive themelohet për të kryer funksionet administrative brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të një ministrie apo Zyrës së Kryeministrit [...]”*

Në këtë rast, AKA është agjenci ekzekutive në kuadër të MASHTI-it dhe e themeluar nga MASHTI-i me Udhëzimin Administrativ MASHT [I] 11/2004 për themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 2002/03 mbi Arsimin e Lartë. Se AKA është institucion (agjenci ekzekutive) në kuadër të MASHTI-it, vërtetohet edhe nga organogrami për organizimin e MASHTI-it dhe nga ueb faqja zyrtare e MASHTI-it.

Vlen të theksohet se vartësia e AKA-së ndaj MASHTI-it, buron edhe nga dispozita e nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, me të cilën parashihet se:

*“3. Drejtori ekzekutiv [i AKA-së] për performancën dhe veprimtarinë e Agjencisë, i përgjigjet ministrit dhe informon Sekretarin e Përgjithshëm [të MASH-it].”*

Gjithashtu, dispozita e nenit 29 paragrafi 2 të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, përcakton se:

*“2. Çdo ministër ushtron, drejtimin dhe mbikëqyrjen e performancës dhe veprimtarisë të agjencive ekzekutive të sistemit ministrior. [...]”*

Agjencia, me rastin e konstatimit të gjendjes si më lartë, ka pasur parasysh edhe dispozitën e nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, me të cilën përcaktohet se: *“Agjencia e Kosovës për Akreditim AKA është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë [...]”*, por kjo pavarësi nënkupton se AKA është e pavarur në kuptim të ushtrimit të përgjegjësisë dhe funksioneve të saj ligjore. Sepse, siç u tha, AKA është agjenci ekzekutive në kuadër të MASHTI-it, e nuk është agjenci e pavarur e themeluar nga Kuvendi i Kosovës konform nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 38 të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.

Nga sa u tha më lartë, Agjencia konstatoi se ushtrimi i njëkohshëm i pozitës së anëtarit të KSHNJ-së së MASHTI-it si dhe pozitës së anëtarit të KSHC-së bie ndesh me dispozitën e nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të LPKI-së, dhe si i tillë duhet të evitohet.

Përgjigja e ofruar nga Agjencia kundër Korrupsionit i referohet vetëm pyetjes tuaj konkrete për konflikt të interesit lidhur me situatën nëse anëtari i Këshillit Shtetëror të Njohjes, mundet që njëkohësisht të jetë edhe anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe nuk trajton çështje tjera, e as nuk është ndërhyrje në përkufizimin e pavarësisë së AKA-së.

Varësisht nga përcaktimi i z. Tosunit se nga cila pozitë do të dorëhiqet, institucioni përkatës obligohet që në afat prej shtatë (7) ditësh, ta njoftoj Agjencinë kundër Korrupsionit me veprimin e ndërmarrë nga z. Tosuni, në respektim të dispozitave ligjore të sipërshënuara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është një përpjekje që të forcohet integriteti në sektorin publik, pastaj është një lloj garance se detyrat publike do të kryhen në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik dhe kjo kryesisht nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesit.

*Agjencia kundër Korrupsionit ju falënderon për bashkëpunimin dhe ju inkurajon që këtë ta bëni edhe në të ardhmen.*

*Me respekt !*